



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 49/6 Prot.

Tiranë, më 01.04.2016

V E N D I M
Nr. 39, datë 01.04.2016

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 49/1 prot., datë 22.01.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Pukë, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE :

Mbi bazën e informacionit të përcjellë nga punonjësja ***** , rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 49 prot., datë 20.01.2016, Komisioneri ka nxjerrë urdhrin e verifikimit, nr. 49/1 prot, të datës 22.01.2016, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në lidhje me sqarimin e problemit të ngritur në këtë rast, i cili ka të bëjë me parregullsi gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në zbatim të këtij akti, u krye hetimi i plotë administrativ, u administrua dokumentacioni i nevojshëm për trajtimin e plotë të rastit dhe më pas u vlerësua ligjshmëria e veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak ristrukturimi, të punonjësës ***** , në pozicionin e punës "Përgjegjëse e Zyrës së Financës", në Njësinë Administrative Qerret, Pukë.

Nga analiza e akteve të administruara, rezulton se, punonjësja në fjalë ka filluar punë, në datën 01.11.2000, në pozicionin "Specialiste e Financës", në Komunën Qerret Pukë. Më pas, me Vendimin e datës 25.02.2008, të Kryetarit të Komunës Qerret, ajo është emëruar, në pozicionin "Përgjegjëse e seksionit të kontrollit/ revizionit të Financës", në Komunën Qerret Pukë.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e ka gjetur atë në të njëjtën klasë dhe kategori, pavarësisht ndryshimit të emërtesës, prandaj, me të drejtë, njësia përgjegjëse e Komunës Qerret, me Vendimin nr. 2, datë 14.04.2014, ka konfirmuar statusin e punësimit të saj, si nëpunëse civile në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit”.

Bazuar në ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Këshilli Bashkiak, Pukë, me Vendimin nr. 7, datë 03.08.2015, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative të saj.

Mbi këtë bazë, Kryetari i Bashkisë Pukë, me Urdhrin nr. 59, datë 14.08.2015, ka miratuar strukturën tranzitore të administratës së institucionit, së bashku me Njësitë Administrative, që tashmë janë pjesë përbërëse të bashkisë.

Sipas kësaj strukture rezulton se, Njësia Administrative Qerret, ka pësuar shkurtim të numrit të vendeve të punës, nga 27 pozicione, prej të cilave 11 të përfshira në shërbimin civil, që kishte struktura e mëparshme, në 18 pozicione, në strukturën e re, prej të cilave vetëm 4 pozicione pune, bëjnë pjesë në shërbimin civil.

Nisur nga ky fakt, arrihet në përfundimin se institucioni është përfshirë në procesin e ristrukturimit, pasi rezulton se ka shkurtim real të numrit të pozicioneve të punës dhe riorganizim të tyre.

Ndodhur në këto kushte, Kryetari i Bashkisë Pukë, bazuar në nenin 50, pika 6, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), ka njoftuar punonjësen ***** për përfshirjen në këtë proces ristrukturimi, me shkresën nr. 525/25 prot., datë, 25.08.2015 “Për zbatimin e procedurës për lirim nga shërbimi civil” dhe në vijim, me shkresën nr. 863 prot., datë, 12.10.2015, “Për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, në njësinë administrative Qerret, për shkak ristrukturimi”, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për këtë punonjëse.

Në rastin konkret, konstatoj se, në Njësinë Administrative Qerret, ka shkurtim të dukshëm të pozicioneve të punës, sidomos të atyre që bëjnë pjesë në shërbimin civil, (të cilat janë shkurtuar në masën, mbi 50%), por konstatohet gjithashtu që, procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për ata punonjës, pjesë e shërbimit civil, të cilëve iu është shkurtuar, apo ristrukturuar pozicioni i punës, vjen në kundërshtim me rregullat dhe rendin e përcaktuar në pikat 2, 3, e vijues, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Komisioni i Ristrukturimit, në Bashkinë Pukë, i ngritur në bazë të pikës 3, të dispozitës së sipërpërmendur, dhe Vendimit nr. 171, dt. 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullim dhe lirim nga shërbimi civil”, ngarkohet me detyrën e shqyrtimit të mundësive të sistemit të çdo nëpunësi civil, në vendet e lira ekzistuese dhe më pas, të propozojë tek njësia përgjegjëse, transferimin e nëpunësit, vendi i punës të cilit është shkurtuar, në një pozicion tjetër të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.

Në vijim të analizës, duke u nisur nga shqyrtimi dhe krahasimi i dokumentacionit, sipas strukturës së re, vihet re se është shkurtuar pozicioni i punës “Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Ekonomisë”, në Njësinë Administrative Qerret, por nga ana tjetër, vijon të jetë pjesë e strukturës, pozicioni i punës “Specialist Finance”. Detyra e Komisionit të Ristrukturimit, në këtë rast, në zbatim të rendit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, do të ishte që të vlerësonte fillimisht, nëse ekzistonte mundësia për sistemimin në këtë pozicion të mbetur, pikërisht të punonjësës që mbante më parë pozicionin e përgjegjëses së kësaj zyre (dmth, nëpunësen *****), duke evidentuar edhe pëlqimin, ose mospëlqimin e saj me shkrim, për uljen në detyrë.

Në vlerësimin e mundësisë së sistemimit të nëpunëses në fjalë, nëse Komisioni i Ristrukturimit do të ishte ngritur dhe do të kishte funksionuar astu siç duhet, ndër të tjera kishte për detyrë, të mbante parasysh edhe përparësinë që i jep familjes së saj, statusi “Familje e Dëshmorit të Atdheut”. Ky status i është njohur familjes së kësaj punonjëseje, me Vendimin nr.70 dt. 28.09.2007, të Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, pranë Këshillit të Ministrave, në mbështetje të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, në nenin 19, të të cilit përcaktohet se: “Pjesëtarët e familjeve të dëshmorëve, kur kanë statusin si i papunë, ose i pastrehë, u sigurohet përparësi në strehim e punësim, nga organet e pushtetit vendor”.

Vetëm nëse kjo nëpunëse, nuk plotësonte kërkesat e veçanta, sipas përshkrimeve të reja të punës, ose në rast të shprehjes së mospranimit prej saj, të vendit të mbetur të punës, mund të vijonte procedura e plotësimit të pozicionit të pretenduar, nëpërmjet transferimeve, sipas radhës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit në fjalë.

Por, nga verifikimi i praktikës dokumentare, për mënyrën se si është proceduar në rastin konkret, vërehet se ekziston vetëm Urdhri nr. 58 datë, 14.08.2015, i Kryetarit të Bashkisë Pukë “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e VKM-së nr. 510 datë 10.06.2015”, si dhe aktet administrative, që materializojnë njoftimin e fillimit të procesit të zgjidhjes së kontratës së punës dhe më pas ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak të ristrukturimit.

Nga hetimi administrativ i kësaj çështjeje, konstatohet se praktika e ristrukturimit nuk është e shoqëruar me aktet përkatëse që provojnë zbatimin e procedurave specifike në një rast ristrukturimi. Bëhet fjalë për mungesa të akteve të tilla si, 1) urdhri për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; 2) dokumentacioni që materializon mënyrën se si ka funksionuar ky komision dhe propozimet e tij, në lidhje me transferimet, riemërimet dhe lirimet nga shërbimi civil të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar, apo ristrukturuar pozicioni i punës; 3) aktet administrative që provojnë marrjen e pëlqimit me shkrim nga nëpunësit, të cilët janë të detyruar të transferohen në një pozicion tjetër, për shkak të shkurtimit, ose ristrukturimit të pozicionit të mëparshëm të punës; 4) aktet administrative që evidentojnë vendimmarrjen përfundimtare të njësisë përgjegjëse, për miratimin apo refuzimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se akti administrativ nr. 863 prot., dt. 12.10.2015, i Kryetarit të Bashkisë Pukë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të nëpunëses ***** , për shkak të ristrukturimit të institucionit, është nxjerrë duke mos respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*.

Përfundimisht, vlerësoj se, kjo shkelje e rëndë e procedurës, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, dt. 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative”*, e bën veprimin administrativ të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësen ***** , absolutisht të pavlefshëm dhe si i tillë, akti administrativ që e ka materializuar atë, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore.

Në këto rrethana, akti administrativ nr. 863 prot, datë 12.10.2015, i Kryetarit të Bashkisë Pukë, *“Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në njësinë administrative Qerret për shkak ristrukturimi”*, duhet të revokohet dhe procesi i ristrukturimit, si për rastin e punonjëses ***** , ashtu dhe për gjithë rastet e tjera të ngjashme, duhet të kryhet nga fillimi, sipas kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* dhe akteve përkatëse nënligjore që e rregullojnë këtë institut të ligjit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative në R.SH”*; nenin 35 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” ,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ nr. 863 prot, datë 12.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Pukë, *“Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në njësinë administrative Qerret për shkak ristrukturimi”*, për punonjësen *****.
2. Të kryhet procesi i ristrukturimit të institucionit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 50, pika 3 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve dhe afateve të përcaktuara në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.
3. Në rastin e pamundësisë së sistemimit të punonjësve që u është shkurtuar, ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke u njohur atyre, përfitimet prej pikave 7 dhe 8, të nenit të mësipërm, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e

lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.

4. Në rastin e nëpunëses *****, Komisioni i Ristrukturimit në Bashkinë Pukë, duhet të ketë parasysh edhe përparësinë që lidhet me statusin që ka familja e saj *“Familje e Dëshmorit të Atdheut”*.
5. Bashkia Pukë, të zbatojë vendimin brenda **15** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për zbatimin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Pukë dhe kërkuesja *****.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA